

KONKLuzionet Operacionale te Mbledhjes së Komitetit Shumepalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur

DATA: 09/02//2023

KRYESOHET: Znj. Milva EKONOMI, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve, Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP)

MBLEDHJA: No.3

ÇËSHTJET E DISKUTUARA:

Çështja Nr.1 *Miratimi i Dokumentit të Prioriteteve në kuadër të procesit të bashkë-bërjes*

KONKLuzionet

1. Në përputhje me kërkesën e kryer nga Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP) Znj. Milva Ekonomi, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve të gjithë ministrat/institucionet të cilat nuk kanë caktuar një pikë kontakti duhet të paraqesin dhe caktojnë pikën e kontaktit lidhur me masat e zbatuara për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP), si dhe planin e veprimit për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP).
2. Dërgimi i prioriteteve nga Ministria e Brendshme të cilat do të dërgohen në Kabinetin e Ministrisë të Shtetit për Standardet e Shërbimeve për tu inkuorporuar në dokumentin e prioriteteve.
3. Sintetizim i prioriteteve nga Ministria e Mbrojtjes të cilat do të dërgohen në Kabinetin e Ministrisë të Shtetit për Standardet e Shërbimeve për tu inkuorporuar në dokumentin e prioriteteve.
4. Dërgimi i prioriteteve nga Agjencia e Prokurimeve Publike që lidhet me forcimin e e regjistrit të prokurimeve që parashikon tre komponentë (i) sistemin e menaxhimit për shqyrtim të ankesave (ii) sistemin e menaxhimit të kontratave dhe (iii) sistemin e menaxhimit lidhur me kontratat koncencionare, që do të dërgohen në Kabinetin e Ministrisë të Shtetit për Standardet e Shërbimeve për tu inkuorporuar në dokumentin e prioriteteve.

5. Dërgimi i prioriteteve nga Ministria e Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentin, të cilat do të dërgohen në Kabinetin e Ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve për tu inkorporuar në dokumentin e prioriteteve.
6. Dërgimi i sugjerimeve shtesë nga anëtarët e shoqërisë civile të Komitetit të cilat do të dërgohen në Kabinetin e Ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve për tu inkorporuar në dokumentin e prioriteteve.
7. Anëtarët e Komitetit aprovuan dokumentin sipas diskutimeve dhe në përputhje me procedurat paketa publikohet në faqen www.ogp.al